



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za žalbe i Predstavke

Anr.567/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Burim Ademi – Kryesues dhe Ferki Xhaferi e Zyhdi Haziri anëtarë, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga Qendresa Kuqi me vendbanim në Zvicër, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), lidhur me mos përfshirjen në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahen me datën 17 tetor 2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 01.09.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.567/2021 i paraqitur nga Qendresa Kuqi me vendbanim në Zvicër, me të cilin kërkon që të përfshihet në listën e votuesve jashtë Kosovës për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahen me datën 17 tetor 2021.

A r s y e t i m

Me datën 31.08.2021 PZAP-i ka pranuar një apel nga Qendresa Kuqi me vendbanim në Zvicër, përmes së cilës ka kërkuar shqyrtimin e apelit pasi që sipas saj gjatë ngarkimit të dokumenteve për aplikim për votues jashtë Kosovës, gjatë ngarkimit të dokumenteve në email nuk ia ka bashkangjitur ID-në e Kosovës, dhe e njëjta kërkon që pas shqyrtimit të apelit të përfshihet në listën e votueseve jashtë Kosovës

Parashtruesja e apelit, si dëshmi ka bashkangjitur formularin e aplikimit për votim jashtë Kosovës, pasaportën e Kosovës, nga i cilit rezulton se i ka skaduar afati ne vitin 2017 dhe patentë shoferin e Zvicrës.

Me datë 31.08.2021 PZAP ka parashtruar kërkesë për përgjigje pranë KQZ, me të cilën ka kërkuar që të njoftohet lidhur apelin e parashtruar nga pala ankuese deri me datë 31.08.2021 në ora 17:00.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve brenda afatit kohor ka paraqitur përgjigje në kërkesë në të cilën ka theksuar se përgjatë periudhës së aplikimit për regjistrim për votim jashtë Kosovës Qëndresa Kuqi, së bashku me aplikacionin për regjistrim ka dërguar kopjen e dokumentit identifikues të shtetit ku jeton, me të cilën vërtetohet kriteri i identitetit, por jo edhe kriteri ligjor për tu përfshirë si votues jashtë Kosovës. Tutje theksohet se apeluesja nuk e ka bashkangjitur kopjen e pasaportës në aplikim në email, sikurse e ka dërguar me shkresat e apelit.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoj të gjitha pretendimit e apelit, në kuptim të nenit 117 par.2 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli, pasi shqyrtoi lëndën konstatoi se apeli është i pabazuar pasi që parashtruesja e apelit gjatë periudhës për aplikim për regjistrim për votim jashtë Kosovës nuk ka bashkangjitur asnjë dokument me të cilën dëshmon se e njëjta është shtetase e Republikës së Kosovës dhe plotëson kushtin ligjor për tu përfshirë në listën e votuesve jashtë vendit, për këtë arsye edhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me të drejtë ka refuzuar aplikimin e saj për përfshirje në listën e votuesve jashtë Kosovës.

Paneli, vlerëson se parashtruesja e apelit në mbështetje të pretendimeve të saj ka ofruar dëshmi se e njëjta ka aplikuar për regjistrim për votues jashtë vendit, duke bashkangjitur në shkresat e apelit aplikacionin të cilën e ka dorëzuar me email, por e njëjta nuk ka ofruar dëshmi se në momentin e aplikimit me email ka bashkangjitur edhe dokumentin identifikues të Republikës së Kosovës, ku këtë fakt e vërteton edhe vet parashtruesja e apelit duke deklaruar se në momentin e aplikimit ka harruar ta ngarkoj letërnjoftimin e Republikës së Kosovës, gjithashtu ky fakt vërtetohet edhe nga përgjigja në apel e KQZ-së, ku thuhet se e njëjta në momentin e aplikimit nuk na ka bashkangjitur asnjë dokument të Republikës së Kosovës, ashtu siç e ka bashkangjitur në shkresat e apelit.

Paneli për vendimin e saj u bazua në nenin 3.3 pika b) të Rregullës Zgjedhore 03/2013 të KQZ-së ku përcaktohet se:

3.3 Personi i cili ka për qëllim të hedhë votën për Votim Jashtë Kosovës...do të regjistrohet në KQZ si votues jashtë Kosovës duke dorëzuar:

b) dëshminë e dokumentacionit të identitetit dhe që ai ose ajo i plotëson kriteret ligjore për të drejtën për të votuar në pajtim me nenin e LZP-së dhe të bashkangjiten dokumentet e fotokopjuara siç janë të renditura në Shtojcën III. të kësaj rregulle,

Nga shkresat e lëndës Paneli, vlerësoi se apeli i parashtruar nga Qendresa Kuqi nuk është i bazuar në dispozita ligjore ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lart si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 par.3, 118 par.1, 122 par.1 pika a) të LZP-së, si dhe nenit 11 par.6 të Rregullës Nr.02/15 të PZAP-it, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.567/2021 më datën 01.09.2021



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa, sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këë vendimi.